



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Maj 2022

Nr: 169

V E N D I M

PËR

**SHQYRTIMIN E DENONCIMIT TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR ORGANIZATA**  
**“QENDRESA QYTETARE” NDAJ BASHKISË SHKODËR, PËR SHKELJE**  
**ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E**  
**PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 19 Maj 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

**Kërkues:** Organizata “Qendresa Qytetare”

**Objekti:** Miratim vendimesh nga Bashkia Shkodër të akteve nënligjore, në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor.

**Ndaj:** Bashkisë Shkodër

**Baza ligjore:** Nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e

veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

## V Ë R E N:

### I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 04.03.2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar nga Qendresa Qytetare, denoncimi me nr. 3677 ID unik i gjeneruar nga sistemi, ora 3:59 PM, ku pretendohet se në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në datë 04.02.2022, është zhvilluar mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër, ku janë miratuar akte, të cilat nuk lejohen të nxirren në periudhë zgjedhore.

Sipas denoncuesit “Në datën 04.02.2022, është zhvilluar mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër; ku ndër të tjera, referuar rendit të ditës si më poshtë: “1. Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2021” . 2. Pr/Vendim: “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2022 dhe miratimin e bashkëfinancimit për këtë program”... 4. Pr/Vendim: “Për një ndryshim në VKB nr. 6, datë 30.1.2018 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar 5. Pr/Vendim:”Për miratimin e vlerësimit paraprak dhe masës së shpërblimit për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme (truall), pronë private, që preken për efekt investimi publik të objektit rikonstruksion rruga e korpusit, bashkia Shkodër”. 6. Pr/Vendim:”Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.”

Rezulton të jenë miratuar të gjitha pikat e rendit të ditës nga anëtarët e këshillit bashkiak.

Në vijim në datën 28.02.2022, është njoftuar mbledhja e radhës e këshillit bashkiak Shkodër, e cila është mbajtur vetëm tre ditë më pas, në datën 03.03.2022, në kundërshtim me rregulloren e kësaj bashkie, konkretisht nenin 37, i cili parashikon njoftimin e mbledhjes jo më para se 5 ditë pune nga njoftimi i saj.

Gjatë kësaj mbledhje pjesë e rendit të ditës janë propozuar për votim projekt vendimet si më poshtë:  
“1. P/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2022. 2. P/Vendim: “Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar 6% për ndihmën ekonomike.”

2. Nisur nga rrethanat e faktit, këto dy mbledhje të mbajtura në kundërshtim me rregulloren e këshillit bashkiak, për sa i përket afateve që kjo e fundit parashikon, në referim edhe të kohës që janë mbajtur e cila përkon me periudhën zgjedhore, shkojnë gjithashtu në kundërshtim edhe me parashikimet e Kodit Zgjedhor, neni 91, pika 4, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Neni 3, pika 3, e Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator, parashikojnë në mënyrë eksplicite ndalimin e propozimit, miratimit ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., katër muaj para datës së zgjedhjeve.

Bashkëlidhur denoncimit janë dërguar edhe provat forografike dhe link si më poshtë:

1- [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=251670867150971&id=100069241770930](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=251670867150971&id=100069241770930)

2- [https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet\\_e\\_Keshillit\\_169\\_1.php](https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet_e_Keshillit_169_1.php)

3- [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=265843635733694&id=100069241770930](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=265843635733694&id=100069241770930)

4- [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=267278778923513&id=100069241770930](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=267278778923513&id=100069241770930)

3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “P” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- d) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

4. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.
5. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
6. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj bashkisë Shkodër, ndaj të cilës atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

## II. Rrethanat e faktit

7. Në denoncimin e raportuar pretendohet se bashkia Shkodër, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ, ka miratuar akte të cilat sipas denoncuesit parashikojë përfitime për kategori të caktuar njerëzish.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës nr. 1573 prot., datë 05.03.2022, me lëndë “Kërkesë për informacion”, i ka kërkuar bashkisë Shkodër informacion sqarues në lidhje me pretendimet e ngritura nga pala denoncuese dhe vendimmarrjen e tyre.

Nëpërmjet shkresës nr. 3672/1 prot., datë 09.03.2022, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1573/1 prot., datë 11.03.2022, bashkia Shkodër pretendon se:

-Këshilli bashkiak Shkodër, ka zhvilluar dy mbledhje, përkatësisht më 04.02.2022 (njoftuar më 31.01.2022) dhe më 02.03.2022 (njoftuar më 28.02.2022)

-Përsa i përket pretendimit se mbledhja e dytë është zhvilluar në shkelje me rregulloren e mbledhjes së këshillit, sipas të denoncuarit, neni 42 i rregullores së këshillit parashikon se “Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së këshillit, bëhet nga sekretari, si rregull jo më pak se 5 ditë pune”. Termi “si rregull” është përdorur për të krijuar fleksibilitet sipas natyrës së çështjeve, për zhvillimin e mbledhjeve dhe lënien afat për njohjen me dokumentacioni, por kjo nuk do të thotë se mbledhjet nuk mund të zhvillohen dhe më herët. Rendi i ditës miratohet nga këshilli dhe janë këshilltarët ata të cilët me votë dakordësojnë ose jo mbi këtë rend dite.

8. Neni 91, pika 4, e Kodit Zgjedhor parashikon se “*Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore*”. Referuar këtij neni, kufizimet për veprimtarinë e këshillit bashkiak lidhet vetëm me rastet e zgjedhjeve të përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, edhe në rast se do të ishim në rastet e kufizimeve të parashikuara më sipër, vendimmarrja e këshillit bashkiak nuk bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor pasi:

- Për vendimin “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2021”, Këshilli Bashkiak Shkodër nuk ka parashikuar “**rritjen e mbështetjes ekonomike apo sociale**”, por vetëm ka zbatuar detyrimet ligjore dhe nënligjore të normuara nga qeveria shqiptare, nuk ka aplikuar rritje të ndihmës ekonomike për asnjë familje përfituese.
- Për vendimin “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2022 dhe miratimin e bashkëfinancimit për këtë program”, lista e aplikuesve në këtë program strehimi i është përcjellë në Nëntor të 2021, ministrisë përkatëse për parashikimin e fondeve për financim për strehim për vitin 2022. Në mbledhjen e datës 09.12.2021 të këshillit bashkiak, është miratuar lista e përfituesve dhe u është lënë 2 muaj afat për plotësimin e dokumentacionit. Vlera e subvencionimit të qirave përcaktohet me akte ligjore dhe nënligjore dhe në rastin konkret Bashkia Shkodër ka zbatuar detyrimet ligjore duke mos aplikuar rritje të subvencionimit të qirasë për asnjë familje.
- Për vendimin “Për një ndryshim në VKB nr. 6, datë 30.1.2018 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar, këshilli bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për qeverisje vendore, i ndryshuar, pas miratimit të buxhetit afatmesëm dhe buxhetit vjetor, ka detyrimin dhe përgjegjësinë të miratojë nivelin e pagave për gjithë nëpunësit administrativë, civil dhe shërbimeve publike në bashkinë Shkodër, brenda limiteve të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore. Këshilli bashkiak nuk ka miratuar rritjen e pagave, por vetëm ka zbatuar detyrimet ligjore dhe nënligjore të normuara nga qeveria shqiptare.

- Për vendimin “Për miratimin e vlerësimit paraprak dhe masës së shpërblimit për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme (truall), pronë private, që preken për efekt investimi publik të objektit rikonstruksion rruga e korpusit, bashkia Shkodër”, sqarohet se ky proces ka nisur që në Prill 2021, me Urdhërin nr. 332, datë 06.04.2021, i ndryshuar të kryetarit të bashkisë. Në kuptim të nenit 91, pika 4, ky vendimi nuk parashikon “**privatizim apo dhënien e pasurive apo shpërblimeve**”, por vetëm zbatim të detyrimeve ligjore të normuara nga qeveria shqiptare.
  - Për vendimin “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarr për disa familje” është një proces që ka nisur në vitin 2021 dhe nuk ka pasur dhënie shpërblimi në kuptim të nenit 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor, por vetëm zbatim të detyrimeve ligjore dhe nënligjore duke vlerësuar dëmin e shkaktuar nga fatkeqësia e rënies së zjarrit, duke u përmbajtur akteve të miratauar nga qeveria.
9. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1819 prot., datë 17.03.2022, ka përcjellur për njohje gjetjet e denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Briselda Kadija me funksion: kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër dhe z. Denis Lesha: me funksion sekretar i Këshillit Bashkiak Shkodër, si dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9 datë 06.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, palët në proces, janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.
  10. Brenda afatit të përcaktuar, asnjë nga palët në proces nuk paraqiti pretendime në lidhje me denoncimin e pretenduar, në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2269 prot., datë 27.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 28 Prill 2022, ora 12:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Briselda Kadija me funksion kryetar i këshillit bashkiak Shkodër dhe z. Denis Lesha me funksion sekretar i këshillit bashkiak Shkodër.
  11. Në seancë dëgjimore u paraqit z. Denis Lesha me funksion sekretar i këshillit bashkiak Shkodër. Z.Lesha parashitroi pretendimet e tij në lidhje me rrethanat e faktit si më poshtë: Kryetari i Këshillit Bashkiak është zëri kryesor, thjesht drejton mbledhjet, paraqet rendin e ditës, por personalisht nuk merr vendime. Të gjitha provat i vë në dispozicion të Këshillit Bashkiak dhe vendimet merren nga anëtarët e Këshillit me shumicë votash. Afatet e shqyrtimit janë rutinë. Nuk ndodhemi në kushtet e shkeljes së nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor pasi ky nen flet për formimin e Qeverisë. Edhe nëse do ishim në këto



kushte, përsëri nuk jemi para shkeljeve të pretenduara. Vendimmarrja e Këshillit Bashkiak në lidhje me përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) është vendim për të cilin aplikohet cdo muaj pranë Shërbimit Social. Pas konkludimit, kalon në Bashki. Përsa i përket vendimmarrjes për rritjen e pagave është një vendimmarrje që i takon Qeverisë, Bashkia punon në funksion të saj. Këshilli bashkiak nuk ka miratuar rritjen e pagave, por vetëm ka zbatuar detyrimet ligjore dhe nënligjore të normuara nga qeveria shqiptare. Bashkia thjesht riskedulon pagat, nuk rrisin, respektojnë vijueshmërinë e vendimeve të qeverisë. Vendimi për subvencionimin e qerasë është praktikë vjetore, lista e aplikuesve në këtë program është përcjellë që në Nëntor të vitit 2021, ministrisë përkatëse dhe në mbledhjen e këshillit bashkiak, është miratuar lista e përfituesve, pra skemi shkelje. Për vendimin “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri për disa familje” thjesht janë zbatuar detyrimet ligjore dhe nënligjore duke vlerësuar dëmin e shkaktuar nga fatkeqësia e rënies së zjarrit, duke u përmbajtur akteve të miratuar nga qeveria, nuk mund të pritet muaj vetëm për të konstatuar dëmet nga zjarri. Propozuesi i aktit është Kryetari i Bashkisë. Dëmshpërblimi nga zjarri është procedurë normale, nuk ka lidhje me fushatën, është proces për të cilën kërkohet vendimmarrja e Qeverisë për t’u miratuar. Për vendimin “Për miratimin e vlerësimit paraprak dhe masës së shpërblimit për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme”, ky proces ka nisur që në Prill 2021, dhe është vetëm zbatim i detyrimeve ligjore të normuara nga qeveria shqiptare, nuk mund të lihen pronarët pa dëmshpërblim, ju janë prishur shtëpitë. Çdo vendim kalon për shqyrtimin e ligjshmërisë pranë Prefektit të Qarkut, për miratim si përfaqësues i qeverisë në nivel lokal.

12. Pasi u dëgjuan shpjegimet e palës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pyeti dhe palën tjetër nëse ishte e nevojshme të merren prova të tjera, palët skishin asnjë pretendim dhe kështu i dha fund shqyrtimit në tërësi dhe hetimit administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare.
13. Përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare”, z. Rigels Xhemollari në përfundim të procesit administrativ i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative ndaj Bashkisë Shkodër në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
14. Përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër, z. Lesha, në përfundim të procesit të hetimit administrativ, kërkoi pushimin e shqyrtimit pasi pretendimet e ngritura nga organiza

“Qendresa Qytetare” nuk qëndrojnë, pasi vendimmarja është një procedurë vijimësie pa ndërprerje, konform fondeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

### III. Analiza ligjore

15. Neni 91, i Kodit Zgjedhor, ndalon përdorimin e burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Në zbatim të kësaj dispozite, Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
16. Specifikisht, në pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, parashikohet se “**Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.**”
17. Neni 3, pika 4, e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikon se “**Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë**”.
18. Në qoftë se bëjmë leximin literal të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, “**deri në formimin e qeverisë së re**” duket se legjislatori e kufizon “**miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara**” **vetëm për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend.** Sa më sipër, në mungesë të një dispozite ndaluese, nxjerrja e



kësaj kategorie aktesh për zgjedhjet vendore, qofshin këto dhe të pjeshme, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Bashkia Shkodër nuk mund të procedohet për miratimin e akteve, që në momentin kur janë nxjerrë, nuk janë parashikuar nga Kodi Zgjedhor si shkelje administrative. Në këtë kuadër, miratimi i këtyre akteve prej të denoncuarit mbetet brenda parashikimeve të ligjit.

19. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton se miratimi i akteve nga bashkia Shkodër, është në shkelje të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.
20. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për denoncimin e kryer nga Organizata “Qendresa Qytetare”, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se miratimi i aktit nënligjor nga ana e bashkisë Shkodër, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

### **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Shkodër.
2. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.



Data: 19 Maj 2022

Nr. 169

“Për shqyrtimin e denoncimit të subjektit zgjedhor Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**